



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1452/6 prot.

Datë 21.06.2024

V E N D I M
Nr. 732/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.06.2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*QuantX IT Solutions*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave” me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “*QuantX IT Solutions*” SHPK me NIPT M31904013D dhe adresë Rruga e Dibrës, Njësia Administrative nr. 8, kati i parë, zona kadastrale nr. 8370. 1001 nr. Pasurie 10/2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: “IdentiTek” SH.A me adresë Rruga “Xhanfize Keko”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.05.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave”, me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.

II.2. Në datën 30.05.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|--------------------------------|-----------|---------------------|
| 1. “XPERT SYSTEMS” SHPK | 3.480.000 | skualifikuar |
| 2. “QuantX IT Solutions” SHPK | 3,769,200 | skualifikuar |
| 3. “Optima Communication” SHPK | | pa ofertë ekonomike |

II.4. Në datën 31.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar anulimin e procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

II.5. Në datën 05.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1452/2024 protokoli, datë 06.06.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4167, e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1452/2 prot., datë 06.06.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK si vijon:

“[...]

Nuk eshte paraqitur certifikate e konformitetit te produktit sipas standardit te kerkuar EALA, sic percaktohet ne piken 4 te kapacitetit teknik i kriterëve te vecanta kualifikuese. Dokumenti i paraqitur "Palo Alto Networks Achieves Rigorous Common Criteria EALA+ Certification" nuk permban elementet e nje certifikate konformiteti.”

II.6. Me shkresën me nr. 420/12 prot., datë 11.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1452/3 prot., datë 13.06.2024, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK nga ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar .

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “QuantX IT Solutions” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “[...]OE QuantX IT Solutions, nisur edhe nga sqarimet e AK të dërguara në SPE, në momentin e paraqitjes së ofertës ka paraqitur certifikatën që vërteton se produkti PaloAlto e përmbush kriterin EAL4. AK në arsyen e skualifikimit, citon që Dokumenti i paraqitur me logon Paloalto nuk përmban elementët e një certifikate konformiteti , por nuk ka paraqitur asnjë format standard, udhëzim, urdhëresë, shabllon apo shembull se si duhet të jetë një certifikatë për përmbushjen e kriterit EAL4. Certifikata e paraqitur nga OE QuantX IT Solutions për produktin PaloAlto, shprehet në mënyrë të qartë për përmbushjen e kriterit EAL4, citoj: Palo Alto Networks Achieves Rigorous Common Criteria EAL4+ Certification SANTA CLARA, Kaliforni, 16 maj 2013 /PRNeësWire/ -- Palo Alto Networks? (NYSE: PANÀ), kompania e sigurisë së rrjetit?, njoftoi sot se Palo Alto Networks kanë arritur certifikimin e kriterëve të përbashkëta në Nivelin e Sigurimit të Vlerësimit 4+ (EAL4+), niveli më i lartë i certifikimit të njohur globalisht për kategorinë e fireëall. Kjo arritje shënon përfundimin e njëprocesi rigoroz vlerësimi dhe testimi nga palët e treta. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën nr.7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 4, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

4. Pajisjet që lidhen me sigurinë e rrjetit të cilat operojnë me softëare duhet të jenë minimalisht sipas standardit EAL4. Kjo duhet të vërtetohet nëpërmjet certifikatës së konformitetit të produktit sipas standardit të kërkuar.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, ka paraqitur:

1. Certifikatë lëshuar për Palo Alto Networks, Inc., lëshuar nga Partneriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit, data e lëshimit 31.08.2022;
2. Dokumentin Palo Alto Networks, datë 16.05.2013 (burimi: Rrjeti Palo Alto).

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.4. Në nenin 92, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në

dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes se “*OE QuantX IT Solutions, nisur edhe nga sqarimet e AK të dërguara në SPE, në momentin e paraqitjes së ofertës ka paraqitur certifikatën që vërteton se produkti PaloAlto e përmbush kriterin EAL4. AK në arsyen e skualifikimit, citon që i Dokumenti i paraqitur me logon Paloalto nuk përmban elementët e një certifikate konformiteti, por nuk ka paraqitur asnjë format standard, udhëzim , urdhëresë, shabllon apo shembull, se si duhet të jetë një certifikatë për përmbushjen e kriterit EAL4. Certifikata e paraqitur nga OE QuantX IT Solutions për produktin PaloAlto, shprehet në mënyrë të qartë për përmbushjen e kriterit EAL4, citoj: Palo Alto Networks Achieves Rigorous Common Criteria EAL4+ Certification SANTA CLARA, Kaliforni, 16 maj 2013 /PRNewswire/ -- Palo Alto Networks? (NYSE: PANÀ), kompania e sigurisë së rrjetit?, njoftoi sot se Palo Alto Networks kanë arritur certifikimin e kriterëve të përbashkëta në Nivelin e Sigurimit të Vlerësimit 4+ (EAL4+), niveli më i lartë i certifikimit të njohur globalisht për kategorinë e fireëall. Kjo arritje shënon përfundimin e një procesi rigoroz vlerësimi dhe testimi nga palët e treta. [...]”*, si dhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në datën 23.05.2024, operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, i është drejtuar autoritetit kontraktor me një kërkesë për sqarim, ku konkretisht ka kërkuar sqarim lidhur me *Cfarë dokumenti duhet paraqitur konkretisht për kriterin në fjalë, deklaratë konformiteti, certifikatë CE, Certifikatë RoHs?*

2. Cfarë është standardi EAL4 referuar Katalogut të Standarteve Shqiptare?

Në datën 24.05.2024, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik kërkesës për sqarim të operatorit ekonomik “Quantx IT Solutions” SHPK si vijon: “[...] *Duhet paraqitur certifikata e konformitetit të produktit dhe nivelet e sigurimit të vlerësimit të kriterëve të përbashkëta EAL. Certifikatat CE janë dy llojesh Europiane dhe Kineze*

- *CE- Conformance Europenne (CE)-European conformity*
- *CE – China export*

Deklarata e konformitetit të BE-së është dokumenti në të cilin prodhuesi deklaron se produkti përmbush kërkesat thelbësore të direktivave ose rregulloreve të aplikueshme të markës CE. Markë CE është një shenjë që është zhvilluar për vendet e Bashkimit Evropian, por tani është pranuar në mbarë botën dhe tregon se produktet që mbajnë këtë shenjë përputhen me direktivat e Bashkimit Evropian dhe i nënshtrohen aktivitetëve të nevojshme të vlerësimit të konformitetit. Ndersa certifikatat RoHC janë certifikata që vlerësojnë kufizimin e Substancave të Rrezikshme dhe ndikon në të gjithë industrinë e elektronikës dhe shumë produkte elektrike gjithashtu. RoHS origjinal, i njohur gjithashtu si Direktiva 2002/95/EC. Ndaj certifikimet e cituara nuk mbulojnë parametrat e Certifikimit EAL 4 + sepse thjesht garanton origjinën e produkteve, pra duhet të jetë e cilësuar Certificate of Conformance (COC) certifikatës së konformitetit të produktit, EAL4.

2. Cfarë është standarti EAL4, referuar Katalogut të Standarteve Shqiptare? Nivelet e sigurimit të vlerësimit të kriterëve të përbashkëta - EAL 1 në EAL 4 Në kontrast me kompanitë private të teknologjisë, industrinë si shërbimet thelbësore, agjencitë qeveritare, infrastrukturat kritike dhe organizatat e profilit të lartë nuk mund t'i shmangen çështjes së certifikimit EAL4+. Arsyeja për këtë është se ata duhet të krijojnë një besim të vendosur në produktin ose shërbimin që

përdorin, për të cilin Vlerësimi i Kritereve të Përbashkëta dhe EAL janë ndër zgjidhjet më të mira. Organizatat duhet të marrin në konsideratë certifikatat EAL4+ kur zhvilluesit ose përdoruesit kërkojnë siguri mesatare ose ekstreme, të lartë të siguruar në mënyrë të pavarur. Si rezultat i këtij vlerësimi, agjencitë e profilit të lartë mund të sigurohen që produkti ose shërbimi i tyre është i përgatitur për të kryer kosto shtesë inxhinierike specifike për sigurinë dhe se vlera e aktivitetit të mbrojtur justifikon kostot shtesë të sigurisë. Kriteret e Përbashkëta - Common Criteria (CC) është një program certifikimi ndërkombëtar i pranuar nga shumë vende si një standard i përbashkët për produktet komerciale të IT-së (COTS). Certifikimi CC zakonisht kërkohet nga klientët e qeverisë, por klientët e sektorit publik po e përdorin gjithnjë e më shumë atë si një kërkesë për blerje. Kriteret e Përbashkëta kanë dy klasifikime: Profili bashkëpunues i Mbrojtjes (cPP) dhe niveli i sigurimit të vlerësimit (EAL). Ndaj në përfundim duhet paraqitur Certifikata certifikatës së konformitetit të produktit, EAL 4. të Common Criteria Evaluation Assurance Levels (Nivelet e Sigurimit të Vlerësimit të Kritereve të Përbashkëta).

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 4, të shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, ka kërkuar shprehimisht që *“Pajisjet që lidhen me sigurinë e rrjetit të cilat operojnë me softëare duhet të jenë minimalisht sipas standardit EAL4. Kjo duhet të vërtetohet nëpërmjet certifikatës së konformitetit të produktit sipas standardit të kërkuar”*. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Certifikatë lëshuar për Palo Alto Networks, Inc., data e lëshimit 31.08.2022, Informacionin e shkarkuar nga Rrjetet Palo Alto, datë 16.05.2013, ku përcaktohet *“Rrjetet Palo Alto arrin certifikimin EAL4+ të kritereve rigorozë të përbashkëta”*. Nga verifikimi i certifikatës së dorëzuar rezulton, se Partneriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit, ka lëshuar certifikata të kritereve të përbashkëta për Palo Alto networks, inc, data e lëshimit 31.08.2022. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga certifikata e dorëzuar nga operatori ekonomik, lëshuar nga Partneriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit, dëshmon për produktet palo alto networks PA-220 series, pA-400 Series, PA-800 Series, PA-3200 Series, PA-5200 Series, PA-5450, PA – 700 Series, and VM Series Next-Generation Firewall with PAN-os 10.1, që janë vlerësuar në një laborator testimi të akredituar, duke përdorur Metodologjinë e Përbashkët për Vlerësimin e sigurisë së IT për përputhjen me kriteret e përbashkëta për vlerësimin e sigurisë së IT. Gjithashtu, nga dokumenti i ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Quantx IT Solutions” SHPK, (burimi Paloalto Networks), *“Rrjetet Palo Alto arrin certifikimin EAL4+ të kritereve rigorozë të përbashkëta”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e dorëzuar, operatori ekonomik ka dhënë një indicie që përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 4, të shtojcës nr. 7, *“Kritereve të veçanta të kualifikimit”*, të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër cituar, si dhe nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, se..... *Nuk është paraqitur certifikate e konformitetit të produktit sipas standardit të kërkuar EAL4, sic përcaktohet në pikën 4 të kapacitetit teknik i kritereve të vecanta kualifikuese. Dokumenti i paraqitur "Palo Alto Networks Achieves Rigorous Common Criteria EAL4+ Certification" nuk përmban elementet e një certifikate konformiteti, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285,*

datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “ Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor nëse kishte dyshime lidhur me dokumentin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konkretisht certifikatës së dorëzuar, duhet t’i kërkonte sqarime operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet të kualifikojë operatorin ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, si dhe t’i kërkojë sqarime lidhur me Certifikatën e lëshuar për Palo Alto Networks, Inc., data e lëshimit 31.08.2022, të dorëzuar nga operatori ekonomik, në përmbushje të pikës 4, shtojcës 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave”, me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, sipas vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vëre në djeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

